



Prishtinë, 24 qershor 2008  
Kodi i ZRRE-së: D\_107\_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke marrë parasysh:

1. Dispozitat e Neneve 15.2 dhe 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080;
2. Dispozitat e Nenit 49.2 të Rregullit për Licencimin e Aktiviteteve të Energjisë në Kosovë, dhe Nenit 4 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit,
3. Kërkesën e KOSTT SH.A për derrogim në zbatimin e disa dispozitave të Kodit të Rrjetit dhe Kodit të Matjes të KOSTT SH.A, të datës 05 maj 2008, **në seancën e mbajtur më 24 qershor 2008 nxori këtë:**

### VENDIM

- I. **I lejohet** KOSTT SH.A. derrogimi në zbatimin e dispozitave të neneve të Kodit të Rrjetit dhe Kodit të Matjes si në shtojcë të këtij vendimi.
  1. Të gjitha dispozitat tjera të Kodit të Rrjetit, Kodit të Matjes të Operatorit të Sistemit të Transmisionit do të mbesin në fuqi.
  2. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
  3. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e lejimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
  4. Ky Vendim hyn në fuqi me datën e lëshimit të tij ose datën e publikimit të këtij vendimi në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Bordi i ZRRE-së:**

\_\_\_\_\_  
Ali Hamiti, Kryesues

\_\_\_\_\_  
Theranda Beqiri, Anëtare

\_\_\_\_\_  
Nysret Avdiu, Anëtar



Dispozitat e derroguara nga Kodi i Rrjetit

Nr.	Pjesa e Kodit	Neni	Paragrafi	Periudha e Derogimit (në vite)	Arsyeja e kërkesës
1.	Kodi Operativ	5.5.3 Stabiliteti dhe Mbingarkesa e Rrjetit	5.5.3.3	6 muaj	Mungojnë studimet rutinore mbi sigurinë, priten paisjet PSSE/EMS
2.	Kodi i Balancit	3.9 Programi i Tensionit	3.9.1.1	6 muaj	Me qëllim të nxjerrjes së programit të tensionit janë kërkuar licencat për PSSE me anë të cilit do të bëhen analizat përkatëse.
			3.9.1.2		
			3.9.1.3		
			3.9.1.4		
3.	Kodi i Planifikimit Operativ	3.4.3 Pengesat e Sistemit të Transmisionit	3.4.3.1	6 muaj	Vlerësimi i Sigurisë së Sistemit nuk është i mundshëm për planifikimin afatmesëm dhe afatshkurtë
		3.12 Vlerësimet e Sigurisë së Sistemit Energjetik	3.12.1	6 muaj	Vlerësimi i Sigurisë së sistemit nuk është i mundshëm për planifikimin afatmesëm dhe afatshkurtë
			3.12.2		
			3.12.4		

Dispozitat e derroguara nga Kodi i Matjes

Nr.	Kodi	Neni	Paragrafi	Periudha e Derogimit në vite	Arsyeja e kërkesës
		8.2 Matjet e Kapacitetit (Fuqisë) dhe Energjisë	8.2.2.8	6 muaj	Në TS. Ferizaj akoma bërthama për matje shërben njëkohësisht edhe për mbrojtje.